



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:084599
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05651975

C.nr.236/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Omega, në çështjen juridike të paditëses B.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson D.M, Avokat nga Prizreni, kundër të paditurës E me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 1,500.00 €uro, jashtë seance, më 03.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses B.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura E me seli në Prishtinë, që paditëses t'ia kompensojë dëmin material dhe jo material në shumën prej 3,100.00 €, me kamare ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej datës së paraqitjes së padisë (dt.04.04.2023), si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës aq sa do të bëhen.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja B.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson D.M Avokat nga Prizreni, kanë ushtruar padi kundër të paditurës E, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses avokati D.M, me parashtrësë të veçantë, e ka njoftuar gjykatën se heqë dorë nga padia dhe kërkesëpadia.

Meqenëse, paditësja ka tërhequr kërkesë-padinë në kuptim të nenit 149.2 të LPK-së, nuk është i nevojshëm pëlqimi i të paditurit, për çka Gjykata në kuptim të nenit 149.1 të LPK-së, pa shqyrtim të mëtejme ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 160.6 të LPK-së, në pjesën arsyetuese të këtij Aktgjykimi, janë dhënë vetëm arsytet që justifikojnë dhënien e tij.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë dhe në bazë të neneve 142, 143, 144, 146, 160 dhe 149 të Ligjit për procedurën kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr.236/2023, më datë 03.05.2024

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit–Divizioni Civil në Prishtinë.